



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/149


Datë: 23/9/2022

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 28, paragrafi 1.6 të Statutit të UP-së dhe nenin 6 të Rregullores nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015 të punës së Senatit të UP-së, thërret mbledhjen e 34-të të rregullt të Senatit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së 33-të të Senatit të UP-së, mbajtur me datë 5.9.2022;
2. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve të doktoratës në vitin akademik 2022/2023;
3. Marrja e vendimit për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit të diplomimit për studentët të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve në nivelet baçelor, master dhe doktoratë;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i programeve të studimit:
 - Master i Edukimit në STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Arte dhe Matematikë), 120 ECTS;
 - Doktoratë në Shkencat e Edukimit, 180 ECTS;
 - Psikologji Klinike dhe Komuniteti, MA, 120 ECTS;
 - Antropologji dhe Trashëgimi Kulturor, BA, 180 ECTS;
 - Të drejtat, e drejta penale ndërkombëtare dhe drejtësi tranzicionale, MSc., 60 ECTS;
 - Edukim fizik dhe sport, MSc., 60 ECTS;
 - Inxhinieri elektrike dhe kompjuterike, PhD, 180 ECTS;
 - Matematikë me zbatime, MSc., 120 ECTS;
 - Biologji molekulare, BSc., 180 ECTS;
 - Planifikim hapësinor dhe zhvillim regional, MSc., 120 ECTS.
5. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe Fakultetit të Mjekësisë, sipas Konkursit me nr. prot. 967, datë 4.5.2022;
6. Plotësimi i përbërjes së Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës me dy (2) anëtarë, Këshillit të botimeve me 1 (një) anëtar dhe Komisionit të studimeve me 1 (një) anëtar të ri;
7. Marrja e vendimit për angazhimin e profesorëve vizitorë në Fakultetin Filozofik, për vitin akademik 2022/2023, sipas shkresës me nr. prot. 3/110, datë 26.7.2022;
8. Shqyrtimi i kërkesës me nr. prot. 3/175, datë 8.9.2022 të dekanit të Fakultetit Filozofik, për lejimin e shfrytëzimit të një viti të lirë (pushim sabbatikal) për prof. asoc. dr. Zenun Halili, me qëllim të kërkimeve të fokusuara në Tarleton State University të SHBA-ve;
9. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ditën e hënë, me datë 26.9.2022, me fillim prej orës 14:00.



Kryesues i Senatit të UP-së

Prof. Dr. Naser Sahiti, rektor